



Çfarë duhet të prisni?

KËRKESA IME PËR AZIL



Ndërkohë që prisni për marrjen e një vendimi, mos u largoni drejt një vendi tjetër pa marrë leje.

- Nëse nuk mund të ktheheni në vendin tuaj për shkak se aty do të ishit të pasigurt, mund të kërkonit azil këtu.
- Azili quhet ndryshe edhe mbrojtje ndërkombëtare.
- Për fëmijët (nën 18 vjeç) që kanë mbërritur vetëm, caktohet një person i quajtur kujdestar për mbështetje.
- Pasi të kenë kontrolluar të gjithë informacionin, autoritetet do të vendosin nëse keni apo jo nevojë për azil.

REGJISTRIMI



Autoritetet do të regjistrojnë kërkesën tuaj, do t'ju bëjnë fotografi dhe do t'ju marrin gjurmët e gishtërinjve (nëse jeni mbi 6 vjeç), si dhe do të kontrollojnë dokumentet tuaja.



Do t'ju jepet një dokument që deklaron se keni bërë kërkesë për azil. Ruajeni me kujdes.



Pas regjistrimit, do të merrni një ftesë me datën, orën dhe vendin e intervistës.



Mos e humbni intervistën tuaj të azilit! Nëse jeni sëmure, njoftoni autoritetet.

INTERVISTA JUAJ PËR AZIL



Do t'ju pyesin përse u larguat nga vendi juaj, si dhe në lidhje me familjen tuaj, jetën tuaj në vendin e origjinës dhe udhëtimin tuaj.



Sillni dokumente (kartë identiteti, fotografi, pasaportë) për të vërtetuar historinë tuaj.

NË PRITJE TË INTERVISTËS SUAJ



Do të qëndroni në një vend të sigurt. Gjatë pritjes, mundohuni ta mbushni sa më shumë kohën tuaj të lirë.



Mësoni gjuhën vendase, bëni miq të rinj, luani sporte dhe kujdesuni për shëndetin tuaj.



Kërkojini një këshilltari ligjor ose kujdestarit tuaj që t'ju ndihmojë të përgatiteni për intervistën.

VENDIMI

Pas disa muajsh, do t'ju komunikohet një vendim.



Nëse vendimi është pozitiv, ju mund të qëndroni në këtë vend dhe të transferoheni në një vend të përhershëm strehimi.



Nëse vendimi është negativ, do të informoheni në lidhje me opsionet e sigurta për t'u kthyer në shtëpi. Nëse nuk jeni dakord me vendimin, mund ta kundërshtoni atë në rrugë zyrtare. Kjo procedurë quhet apelim.

MOS HARRONI

- ✓ Mund të kërkonit këshillim nga një avokat lidhur me kthimin apo me mënyrën e apelit të një vendimi negativ.
- ✓ Kërkonit një përkthyes nëse nuk e flisni gjuhën.
- ✓ Nëse e keni të pamundur t'u përgjigjeni pyetjeve që ju bën nëpunësi, mund ta thoni këtë.
- ✓ Të gjithë nëpunësit duhet t'ju trajtojnë me respekt.
- ✓ Bashkëpunoni me nëpunësit. Kërkojuni atyre t'ju shpjegojnë çfarë duan të thonë, nëse fjalët e tyre janë të paqarta.

